



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 188

3 dhjetor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 169/2013 datë 7.11.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë” 7861
Vendim i Kuvendit nr. 63/2013 datë 26.11.2013	Për mënyrën e trajtimit të deputetëve 7862
Vendim i Kuvendit nr. 64/2013 datë 26.11.2013	Për fillimin e procedurave parlamentare për auditimin e veprimtarisë ekonomike të KLSH-së 7863
Rezolutë e Kuvendit datë 26.11.2013	Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri 7864
Vendim i KM nr. 1015, datë 27.11.2013	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, objekte, që preken nga rehabilitimi mjedisor i vijës së mbrojtur bregdetare, Ujë i Ftohtë - tuneli, bashkia e Vlorës 7865
Vendim i KM nr. 1016, datë 27.11.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 752, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës dhe të kriterëve për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe të masës së shpërblimit të tyre”, të ndryshuar 7867
Vendim i KM nr. 1017, datë 27.11.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Financave 7867

Vendim i KM nr. 1018, datë 27.11.2013	Për lejimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si autoritet kontraktues, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, me objekt “Për shërbimet LAN-TO-LAN për lidhjen e degëve të QKR-së me QKR-në, qendër, mirëmbajtjen e këtyre lidhjeve dhe ofrimin e shërbimeve të tjera të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike” 7868
Vendim i KM nr. 1019, datë 27.11.2013	Për lejimin e Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2013 për këtë ministri 7868
Udhëzim i KM nr. 3, datë 27.11.2013	Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr. 1, datë 18.7.2012 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” 7869

LIGJ
Nr. 169/2013

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 160, DATË 15.10.2009, “PËR RREGULLIMIN E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT PËR FUNKSIONARËT PUBLIKË DHE NËPUNËSIT CIVILË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kategoria e dytë, ku përfshihen të gjithë funksionarët e përcaktuar në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, të cilëve u caktohet një përfitim maksimal financiar mujor, sipas vlerës së përcaktuar në po këtë lidhje për shërbime transporti, në përmbushje të detyrave të tyre funksionale. Masa e përfitimit financiar mujor për çdo deputet miratohet me vendim të Kuvendit, në bazë të distancës me zonën që ai përfaqëson, por kjo masë nuk mund të jetë më shumë se 40 000 (dyzet mijë) lekë në muaj.”.

b) Pikat 3 dhe 4 shfuqizohen.

Neni 2

Neni 5 shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.11.2013

Shpallur me dekreten nr. 8410, datë 27.11.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIDHJA NR. 2
PËR PËRFITIMIN FINANCIAR MUJOR TË SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT PËR DISA FUNKSIONE PUBLIKE

Nr.	Funksionet përfituese të kategorisë së dytë	Përfitimi maksimal financiar mujor në lekë
1	Deputet	40 000
2	Kryetar i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare	20 000
3	Kryetar i Autoritetit të Konkurrencës	20 000
4	Kryetar i Komisionit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale	20 000
5	Kryetar i Komisionit të Mbrojtjes nga Diskriminimi	20 000
6	Kryetar i Komisionit të Shërbimit Civil	20 000
7	Kryetar i Autoritetit të Mediave Audiovizive	20 000
8	Kryetar i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	20 000
9	Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë	20 000
10	Kryetar i Entit Rregullator të Furnizimit me Ujë dhe Largimit të Ujërave të Ndotura	20 000
11	Kryetar i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive	20 000
12	Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	20 000
13	Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	20 000
14	Zëvendësministër	15 000



VENDIM
Nr. 63/2013

PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT TË DEPUTETËVE

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 19 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, të ndryshuar, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Paga ditore e deputetit llogaritet mbi pagën bazë, pa përfshirë shpërblimet dhe mbulimin e shpenzimeve. Paga e deputetit përcaktohet sipas nenit 13 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar.

II. Për çdo mungesë pa shkaqe të përligjura në seancat plenare të Kuvendit, deputetit i ndalohet paga ditore. Mungesë pa shkaqe të përligjura, për efekt page, quhet çdo mungesë, përjashtuar rastet kur, me miratimin e Kryetarit të Kuvendit, deputeti merr pjesë në veprimtari parlamentare brenda ose jashtë vendit.

Kryetari i Kuvendit përcakton me udhëzim mënyrën e evidentimit të pjesëmarrjes së deputetëve në seancë plenare.

III. Përveç pagës bazë, deputeti shpërblehet për pjesëmarrje në mbledhje të komisionit të përhershëm ku bën pjesë. Në këtë rast, masa e shpërblimit është 2 000 lekë për çdo mbledhje.

IV. Masa e shpërblimit për kryetarët e komisioneve të përhershme të Kuvendit është 2 500 lekë dhe për kryetarët e nënkomisioneve është 2 200 lekë për çdo mbledhje.

V. Kryetari i grupit parlamentar merr 5-15 për qind mbi pagën e deputetit, në raport me numrin e anëtarëve të grupit.

VI. Pjesëmarrja në komisionet e përhershme paguhet deri në 12 mbledhje në muaj, ndërsa në komisionet e posaçme paguhet sipas vendimit të Kuvendit për krijimin e tyre. Pagesa bëhet sipas listëprezencës së pjesëmarrjes së deputetëve në komisione, të firmosur nga kryetari i komisionit dhe sekretari teknik, dhe verifikohet nga procesverbali i mbledhjes përkatëse të komisionit. Ngarkohet shërbimi i komisioneve dhe sektori i trajtimit të deputetëve të bëjnë verifikimet për çdo rast.

VII. Deputetët që banojnë në rrethin e Tiranës përfitojnë dieta ditore deri në 6 ditë në muaj, ndërsa deputetët që banojnë jashtë rrethit të Tiranës përfitojnë dieta ditore deri në 12 ditë në muaj. Deputetët i përfitojnë dietat pas dorëzimit të dokumentacionit vërtetues, të firmosur nga ana e tyre. Forma e dokumentacionit vërtetues përcaktohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

VIII. Kuvendi mbulon shpenzimet telefonike për deputetët përgjatë gjithë vitit, për vlerën mujore prej 17 000 lekësh. Për kryetarët e komisioneve të përhershme dhe kryetarët e dy grupeve parlamentare më të mëdha vlera mujore është 20 000 lekë.

IX. Kuvendi mbulon shpenzimet për strehimin e deputetëve. Mënyra e përmbushjes së këtij detyrimi përcaktohet me vendim të Byrosë së Kuvendit.

X. Kuvendi mbulon shpenzimin për pagesën e tarifës së pajisjes me pasaportë diplomatike vetëm për deputetët, gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit.

XI. Pagesat e llogaritura sipas pikave VII, VIII dhe IX kalojnë me transfertë në llogarinë personale bankare të deputetit, pas datës 20 të çdo muaji.

XII. Vendimi i Kuvendit nr. 68, datë 20.2.2003, “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

XIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 26.11.2013

VENDIM
Nr. 64/2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PARLAMENTARE PËR AUDITIMIN E
VEPRIMTARISË EKONOMIKE TË KLSH-SË

Në mbështetje të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës, të nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, dhe të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të fillojë procedurat parlamentare për auditimin e veprimtarisë ekonomike të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. Me qëllim ushtrimin e auditimit, sipas legjislacionit në fuqi, ngarkohet Komisioni për Ekonominë dhe Financat për përzgjedhjen e audituesve të jashtëm të pavarur për kontrollin e veprimtarisë ekonomike të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilët do t'i paraqiten Kuvendit për miratim.

III. Komisioni për Ekonominë dhe Financat t'i paraqesë për shqyrtim Kuvendit raportin përfundimtar për audituesit e pavarur të përzgjedhur brenda datës 17.12.2013.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 26.11.2013



REZOLUTË

PËR MBROJTJEN DHE RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË SHQIPËRI

Kuvendi i Shqipërisë:

- E konsideron fëmijën një individ me të drejta të barabarta e të patjetërsueshme në shoqëri, trajtimi i të cilit duhet të ketë në fokus garantimin e zbatimit të parimeve universale dhe udhëheqëse të të drejtave të fëmijës si: mosdiskriminimi, mbijetesa dhe zhvillimi, interesi më i lartë i fëmijës dhe pjesëmarrja e fëmijës;

- Njeh detyrimin e shtetit për të mbrojtur, respektuar dhe promovuar të drejtat e fëmijës, që burojnë nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës e OKB-së, konventat e Këshillit të Europës, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe nga legjislacioni i brendshëm;

- Vlerëson përmirësimet në fushën legjislative, krijimin e institucioneve, mekanizmave të rinj, në mbrojtje të fëmijëve, pa asnjë diskriminim dhe mbështetjen që shoqëria civile ka dhënë në këtë proces;

- Vlerëson kontributin e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë si të domosdoshëm për të përmirësuar dhe rritur efikasitetin e legjislacionit në mbrojtje të fëmijëve, për monitorimin e veprimtarisë së institucioneve dhe mekanizmave të zbatimit të ligjit në drejtim të zbatimit të standardeve të shërbimeve publike ose private, që bëjnë të mundur mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve;

- Rikonfirmon rolin vendimtar që ka Qeveria e Republikës së Shqipërisë në menaxhimin e burimeve të ndryshme njerëzore dhe financiare, në hartimin e Buxhetit të Shtetit, që mundëson financimin e shërbimeve në mbrojtje të fëmijëve dhe të të drejtave të tyre;

- Rikonfirmon rolin vendimtar që luan pushteti vendor në shpërndarjen e buxhetit me efektivitet, në mënyrë që të krijojë mundësinë e funksionimit të mekanizmave, strukturave dhe sistemeve të përshtatshme, për të vepruar me përgjegjshmëri dhe pa asnjë lloj diskriminimi, brenda kompetencave ligjore, ku punonjësi social luan një rol qendror në koordinimin e sistemit vendor të mbrojtjes së fëmijës;

- Mbështet rolin që kryen familja në krijimin e mjedisit të duhur për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për zhvillimin e personalitetit, aftësive dhe njohurive të tyre për t'i ushtruar këto të drejta, si dhe për t'i ndërgjegjësuar ata edhe për detyrat e tyre.

Tërheq vëmendjen:

- Për analizën e thelluar të kuadrit ligjor ekzistues, për të vlerësuar mangësitë e mundshme, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të tij, si dhe për të vlerësuar hartimin e politikave të reja sociale që adresojnë shpërndarjen e drejtë të shërbimeve vendore dhe kombëtare në mbrojtje të fëmijëve;

- Për të nxitur planifikimin dhe shpërndarjen e burimeve të mjaftueshme financiare, në zbatim të legjislacionit në fuqi, për të mbështetur plotësisht shërbimet ekzistuese në mbrojtje të fëmijëve, me fokus të veçantë mbështetjen e funksionimit të Linjës Kombëtare të Telefonit për Fëmijët në Shqipëri (ALO 116) dhe strehëzave në ndihmë të fëmijëve, viktimat të dhunës dhe të keqtrajtimit;

- Për t'i kushtuar një vëmendje dhe kujdes të posaçëm trajtimit dhe kujdesit për fëmijët që jetojnë me HIV/AIDS, për fëmijët me aftësi të veçanta, fëmijët jetimë dhe fëmijët që i përkasin minoriteteve në Shqipëri.

Kuvendi i Shqipërisë angazhohet:

- Të nxisë Qeverinë që në Buxhetin vjetor të Shtetit të mundësojë buxhetin e nevojshëm për shërbimet në mbrojtje të fëmijëve, si dhe krijimin e një fondi të veçantë për fëmijët, nga i cili do të financohen të gjitha institucionet, shërbimet dhe programet për fëmijët në Shqipëri;

- Të ndërmarrë nisma dhe veprime konkrete për hartimin e legjislacionit për drejtësinë për të miturit në Shqipëri;
- Të nxisë e të mbështesë nismat ligjvënëse të deputetëve ose të Qeverisë për përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, kryesisht në drejtim të hartimit të politikave dhe legjislacionit përkatës për shërbimin e kujdestarisë në familje;
- Të nxisë dhe të mbështesë miratimin e Reformës së Shërbimit Social në Shqipëri;
- Të ndërmarrë veprime aktive për ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe familjes për rolin vendimtar që ajo luan në rritjen, përkujdesjen dhe respektimin e të drejtave individuale të fëmijës;
- Të vlerësojë mundësinë e krijimit të Komisionerit për të Drejtat e Fëmijës, pranë Zyrës së Avokatit të Popullit, mes një procesi konsultues të komisioneve parlamentare, Qeverisë, Avokatit të Popullit, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit;
- Të monitorojë në vazhdimësi veprimtarinë e institucioneve shtetërore për zbatimin e legjislacionit për fëmijët, me fokusin e veçantë në Rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës së OKB-së dhe të nxisë Qeverinë për zbatimin e Planit të Veprimit për Fëmijët;
- Të nxisë bashkëpunimin e institucioneve të pushtetit qendror me atë vendor, për të hartuar programe, të cilat duhet të përfshijnë shërbimet shoqërore, decentralizimin e shërbimeve të tjera drejt komunitetit, policimin në komunitet dhe dhënien e ndihmës e të kujdesit për fëmijët dhe familjet në nevojë;
- Të mbështesë nismën dhe kërkesën e shoqërisë civile për të krijuar Grupin e Deputeteve për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, si një grup *ad-hoc* avokatësie të parlamentarëve, që do të nxisin Kuvendin e Shqipërisë për shqyrtimin e nismave dhe veprimeve në mbështetje dhe në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri;
- Të hartohet një plan veprimi nga Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut, në bashkëpunim me strukturat e tjera parlamentare, për përmbushjen e angazhimeve të përcaktuara nga kjo rezolutë.

Miraturar në datën 26.11.2013

VENDIM

Nr. 1015, datë 27.11.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, OBJEKTE, QË PREKEN NGA REHABILITIMI MJEDISOR I VIJËS SË MBROJTUR BREGDETARE, UJË I FTOHTË - TUNELI, BASHKIA E VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 8, shkronjat “ç” e “ë”, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të vendimit nr. 1, datë 8.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në disa zona me rëndësi kombëtare dhe procedurën e hartimit të planit të integruar sektorial për brezin bregdetar” dhe të vendimit nr. 1, datë 23.6.2004 të Këshillit të Rregullimit të Territorit në Republikën e Shqipërisë (KRRTRSH) “Për miratimin e planit të qendrës së Vlorës”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe të ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, objekte, që preken nga rehabilitimi mjedisor i vijës së mbrojtur bregdetare, Ujë i Ftohtë - tuneli, bashkia e Vlorës.



2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Vlorës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Pronarët e ligjshëm të pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme 8396 (tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m² ndërtim, të vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 462 919 230 (katërqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 462 919 230 (katërqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë) lekësh, të përballohet, përkatësisht, 362 919 230 (treqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë) lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 100 000 000 (njëqind milionë) lekë nga fondi i kontingjencës.

5. Pronarët e ligjshëm të pasurive të shpronësuara të kompensohen, për efekt të këtij shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin ligjor të pronësisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit është data 28.12.2013.

7. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave dhe bashkia e Vlorës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

**LISTA E PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA REABILITIMI MJEDISOR
I VIJËS SË MBROJTUR BREGDETARE UJË I FTOHTË - TUNELI,
BASHKIA VLORE**

Nr.	Pasuria objekt ndërtimor	Zona kadastrale	Sipërfaqja	Çmimi mesatar për m ²	Vlera në lekë	Shënime
1	16/8+1-18	8602	55,05	57.000	3.137.850	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	16/8+2-7	8602	62,76	57.000	3.577.320	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	16/8+1-7	8602	43,28	57.000	2.466.960	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	16/8+2-25	8602	97,32	57.000	5.547.240	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	16/8+2-23	8602	97,17	57.000	5.538.690	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	16/8+1-1	8602	47,59	57.000	2.712.630	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	16/8+2-31	8602	62,76	57.000	3.577.320	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	16/8+2-20	8602	43,28	57.000	2.466.960	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	16/8+1-5	8602	71,44	57.000	4.072.080	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	16/8+2-24	8602	46,35	57.000	2.641.950	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	16/8+2-17	8602	97,32	57.000	5.547.240	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	16/8+1-12	8602	55,31	57.000	3.152.670	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	16/8+2-9	8602	88,58	57.000	5.049.060	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	Pjesa e mbetur, bashkëpronarët e objektit	8602	7253.18	57.000	413.431.260	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	TOTALI				462.919.230	

VENDIM
Nr. 1016, datë 27.11.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 752, DATË 2.11.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE TË KRITEREVE PËR
CAKTIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, SI DHE TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË TYRE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 752, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “c” e pikës 1 të kreut III, ndryshohet si më poshtë vijon:
“c) të kenë mbaruar ciklin e dytë të studimeve të larta, në degën Drejtësi.”.
 2. Në pikën 2 të kreut III bëhen këto ndryshime:
 - a) Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë vijon:
“c) të kenë mbaruar ciklin e dytë të studimeve të larta, në degën Drejtësi.”.
 - b) Shkronja “ç” shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1017, datë 27.11.2013

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E FINANCIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 162/2013 “Për miratimin e marrëveshjes për kryerjen e shërbimit të auditimit të borxhit të ministrive kundrejt biznesit vendas dhe të huaj”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme”, në kategorinë e shpenzimeve korente, t’i shtohet fondi prej 85 000 (tetëdhjetë e pesë mijë) eurosh, për kryerjen e pagesave ndaj “Deloitte Albania” sh.p.k., për shërbimin e auditimit të borxhit të ministrive kundrejt biznesit vendas dhe të huaj.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.



3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1018, datë 27.11.2013

PËR LEJIMIN E QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT, SI AUTORITET KONTRAKTUES, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, ME OBJEKT “PËR SHËRBIMET LAN-TO-LAN PËR LIDHJEN E DEGËVE TË QKR-SË ME QKR-NË, QENDËR, MIRËMBAJTJEN E KËTYRE LIDHJEVE DHE OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË TJERA TË PËRMIRËSIMIT TË INFRASTRUKTURËS TEKNOLOGJIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si autoritet kontraktues, të vazhdojë kryerjen e procedurave të prokurimit publik, me objekt “Për shërbimet LAN-TO-LAN për lidhjen e degëve të QKR-së me QKR-në, qendër, mirëmbajtjen e këtyre lidhjeve dhe ofrimin e shërbimeve të tjera të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike”, me fond limit 4 683 876 (katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, pa TVSH.

2. Ngarkohen Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1019, datë 27.11.2013

PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË FINANCAVE, SI AUTORITET KONTRAKTUES, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, ME FONDET E MIRATUARA NË BUXHETIN E VITIT 2013 PËR KËTË MINISTRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2013 për këtë ministri, për objektin sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

Procedurat e prokurimit me objekt:

1. Sistem kompjuterik për monitorimin, auditimin, arkivimin dhe sigurimin e të dhënave tatimore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me fond limit 9,000,000 lekë me TVSH.

UDHËZIM
Nr. 3, datë 27.11.2013

**PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË UDHËZIMIT NR. 1, DATË 18.7.2012 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E DHËNIES ME QIRA TË TOKAVE
BUJQËSORE TË PANDARA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Udhëzimi nr. 1, datë 18.7.2012 i Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, pezullohet për një afat të papërcaktuar.

2. Çdo kontratë qiradhënieje, e lidhur pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, është e pavlefshme.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe kryetarët e bashkive/komunave, në juridiksionin e të cilave ndodhen tokat bujqësore të pandara, objekt i qiradhënies, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 12 lekë